



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Zyra e Kryeministrit - Ured Premijera - Office of the Prime Minister

Nr. 518/2023

Datë: 25/05/2023

Kryeministri i Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 94 dhe 96 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 9 (1.4) të Ligjit Nr.08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, bazuar në nenin 6 (2.1 dhe 2.9) dhe nenin 11, të Rregullores (QRK) Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) nr. 04/2021 dhe Rregulloren (QRK) nr. 03/2022, nxjerr:

V E N D I M

1. Z. Radoica Radomirović emërohet Zëvendësministër në Ministrinë për Komunitete dhe Kthim.
2. Zëvendësministri emërohet për mbështetjen e Ministrit për Komunitete dhe Kthim dhe është përgjegjës për menaxhimin e aktiviteteve në fushat e përcaktuara nga Ministri, për zëvendësimin e Ministrit kur ai mungon ose kur nuk është në gjendje që ta ushtroj detyrën.
3. Zëvendësministri është i obliguar të bëjë deklarinë e pasurisë, në pajtim me Ligjin Nr. 08/L-108 për deklarinë, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë dhe të dhuratave.
4. Obligohet Ministria për Komunitete dhe Kthim dhe Zyra e Kryeministrit për zbatimin e këtij Vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryeministri.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Vendimi i dërgohet:

- Z. Radoica Radomirović, Zëvendësministër në MKK;
- Të gjithë Zëvendëskryeministrave;
- Të gjithë Ministrave;
- Shefit të Stafit të Kryeministrit;
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së;
- Arkivit të Qeverisë.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Zyra e Kryeministrit - Ured Premijera - Office of the Prime Minister

Nr. 517/2023
Datë: 25.05.2023

Kryeministri i Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 94 (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 9 (1.4) të Ligjit Nr.08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, bazuar në nenin 6 (2.1 dhe 2.9) të Rregullores (QRK) Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) nr. 04/2021 dhe Rregulloren (QRK) nr. 03/2022, nxjerr:

V E N D I M

1. Z. Gazmen Salijević lirohet nga detyra e Zëvendësministrit në Ministrinë për Komunitete dhe Kthim.
2. Z. Gazmen Salijević është i obliguar të bëjë deklarin e pasurisë, në pajtim me Ligjin Nr. 08/L-108 për deklarin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë dhe të dhuratave.
- 3.
4. Obligohet Ministria për Komunitete dhe Kthim dhe Zyra e Kryeministrit për zbatimin e këtij Vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryeministri.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Vendimi i dërgohet:

- Z. Gazmen Salijević;
- Të gjithë Zëvendëskryeministrave;
- Të gjithë Ministrave;
- Shefit të Stafit të Kryeministrit;
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së;
- Arkivit të Qeverisë.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Zyra e Kryeministrit - Ured Premijera - Office of the Prime Minister

Nr. 516/2023
Datë: 25.05.2023

Kryeministri i Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 94 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 32 paragrafi 4 të Ligjit nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, si dhe duke pasur parasysh nenin 6 (2.1) të Rregullores (QRK) - Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) nr. 04/2021 dhe Rregulloren (QRK) nr. 03/2022, nxjerr:

V E N D I M

1. Znj. Edi Gusia, Udhëheqëse e Divizionit për Raportim dhe Raportim në Agjencinë për Barazi Gjinore në kuadër të Zyrës së Kryeministrit (ABGj), caktohet Zëvendësuese e Drejtorit Ekzekutiv në ABGj në kuadër të Zyrës së Kryeministrit.
2. Zëvendësuesja e Drejtorit Ekzekutiv në ABGj, autorizohet të kryejë të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë e Drejtorit Ekzekutiv, deri në nxjerrjen e një vendimi tjetër brenda afateve ligjore.
3. Detyrat dhe përgjegjësitë e Drejtorit Ekzekutiv në ABGj, janë të përcaktuara me legjislacionin në fuqi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryeministri.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Vendimi i dërgohet:

- Znj. Edi Gusia, zv. e Drejtorit Ekzekutiv në ABGj/ZKM;
- Shefit të Stafit të Kryeministrit;
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së;
- Agjencisë për Barazi Gjinore (ABGj);
- Arkivit të Qeverisë.